



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë-Albania, Tel/Fax: 04 2226814; 22268142

Nr. 213/Prot.  
1

Tiranë, më 27 .02 .2015

V E N D I M

Nr. 12 , datë 27 .02 .2015

**“Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë”**

Gjatë hetimit administrativ të disa rasteve të lirimit nga shërbimi civil të ish punonjësve të institucionit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, për shkak të ristrukturimit, u çmua e arsyeshme që të verifikohet në tërësi procesi sipas parashikimeve të nenit 50 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar me ligjin 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave,

Për këtë arsye

Me propozim të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, bazuar në nenin 11, pika 1 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me qëllim verifikimin e procesit të ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, si dhe lëvizja, transferimi apo lirimi nga shërbimi civil i punonjësve, (për shkak të ristrukturimit)

**VENDOSA:**

1. Fillimin e inspektimit të përgjithshëm të procesit të ristrukturimit të institucionit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.
2. Ngritjen e grupit të inspektimit, me këtë përbërje:
  - Ilirjan Osmanlliu
  - Zamira Mujali
3. Inspektimi të përfshijë verifikimin e respektimit të procedurës së praktikës së ristrukturimit; punonjësit e liruar dhe mbajtur pas ristrukturimit; kontrollin e përkrahjeve të punës dhe përshtatshmërinë e nëpunësve të mbajtur, me kërkesat e vendeve përkatëse të punës.

4. Ky inspektim të kryhet prej datës 02.03.2015 deri në dt. 15.03.2015.
5. Relacioni të përgatitet nga Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ dhe t'i paraqitet Komisionerit për miratim.
6. Të merren masat për njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet inspektimit në përputhje me nenin 47 të Kodit të Procedurës Administrative.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**